

NUSRET HALITI

Ekspert për Telekomunikacion, Rrjete dhe Inxhinieri Softuerike

Themelues & CEO, Bridge-Technology

Tetovë, Maqedonia e Veriut

Nusret Haliti është ekspert në telekomunikacion dhe arkitekturë sistemesh, me mbi dy dekada përvojë në projektimin dhe implementimin e infrastrukturave dhe ekosistemeve digjitale në shkallë të gjerë.

Magjistër i Shkencave në Sisteme të Integruara Mikrokompjuterike dhe i diplomuar në Elektronikë dhe Telekomunikacion në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Teknologjive të Informacionit, pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup.



Gjatë karrierës së tij ka projektuar dhe implementuar rrjete IP në shkallë të gjerë, arkitektura VoIP, sisteme wireless broadband, infrastrukturë satelitore, platforma AAA (Authentication, Authorization and Accounting) si dhe sisteme të shpërndara me disponueshmëri të lartë (high-availability distributed systems). Përvoja e tij përfshin operatorë telekomunikacioni, infrastruktura të mëdha, mjedise embedded, projekte të konektivitetit dhe zhvillim sistemesh softuerike.

Si themelues dhe CEO i Bridge-Technology, ai udhëheq iniciativa komplekse në telekomunikacion dhe inxhinieri softuerike që integrojnë teknologji rrjetesh, sisteme embedded, siguri dhe automatizim në ekosisteme teknologjike të qëndrueshme dhe të shkallëzueshme (scalable).

Ai është gjithashtu arkitekt dhe krijues i WellnessMetric – një platformë digjitale shëndetësore e ndërtuar sipas parimeve të arkitekturës telekomunikacioni, që mbështet Remote Patient Monitoring (RPM), Chronic Care Management (CCM) dhe Remote Therapeutic Monitoring (RTM), e cila funksionon me sukses prej disa vitesh në Shtetet e Bashkuara. Platforma reflekton filozofinë e tij profesionale: aplikimin të sigurisë së lartë, monitorim inteligjent dhe arkitekturë të sigurt në sisteme shëndetësore të gjeneratës së re.

Fokusi i tij profesional përfshin:

- Arkitekturë e sistemeve telekomunikuese në shkallë të gjerë
- Dizajn i infrastrukturave të shpërndara dhe fault-tolerant
- Inxhinieri e rrjeteve wireless dhe satelitore
- Integrim i sistemeve embedded
- Monitorim inteligjent, automatizim dhe sisteme të mbështetura nga AI

Nusret Haliti njihet për integrimin e inxhinierisë telekomunikuese me arkitekturë të avancuar softuerike, duke ofruar sisteme që operojnë me besueshmëri të lartë (high availability) dhe standarde të avancuara sigurie.